



# EU POLICY

# BRIEFS MACEDONIA



October 2013

[www.kas.de/macedonia](http://www.kas.de/macedonia)  
[www.analyticamk.org](http://www.analyticamk.org)

## Varfëria Energjetike në Maqedoni

Varfëria energjetike veçse ka sfiduar Maqedoninë e cila paraprakisht ishte e brishtë në rrugën e saj drejt integritit në BE. Ky dokument analizon gjendjen e varfërisë energjetike në Maqedoni dhe politikat që trajtojnë këtë çështje në mënyrë që të hartohen rekomandime politike për përmirësimin e tyre nga ana e aktorëve relevant. Trajtimi i varfërisë energjetike është i rëndësishëm për sjelljen e vendit në një rrugë të qëndrueshme

**ANA STOJLOVSKA & SONJA  
ZUBER**

Analytica Think-Tank, Maqedoni

---



## HYRJE

Si rrjedhoje e përpjekjeve të saja për integrim në BE, Maqedonia ka pësuar shumë reforma politike; dhe, as sektori energjetik nuk i ka shpëtuar këtij procesi reformues. Korniza kryesore ligjore për zhvillimin e politikave energjetike është miratuar<sup>1</sup> dhe zbatimi përkatës ka filluar. Megjithatë, transformimi në ekonominë e tregut ka sjellë reforma siç janë rritja e çmimeve të energjisë; dhe duke marrë parasysh infrastrukturën e vjetër energjetike të vendit, zhvillimin e dobët dhe mungesën e planifikimit strategjik në sektorin energjetik në të kaluarën; këto ndryshime të tregut energjetik dukshëm kanë ndikuar mbi standardin jetësor të qytetarëve të Maqedonisë, që shumica e tyre vetëm më ishin përballuar me një shkallë të lartë të varfërisë dhe papunësisë.

Varfëria energjetike është një term relativisht i ri, me definicione dhe aplikime të shumta, që në mënyrë serioze ndikon vendet që janë në tranzicion energjetik, përfshirë edhe Maqedoninë. Autoritetet e vendit kanë tentuar të trajtojnë këtë çështje, megjithatë protestat masive shoqërore kundër rritjes së çmimeve të energjisë në vitin 2012, nën parullën "AMAN<sup>2</sup>", treguan që masat e ndërmarra janë të pamjaftueshme, që një pjesë shumë më e madhe e popullatës është ndikuar nga rritja e çmimeve të energjisë dhe që duhet bërë shumë më tepër përpjekje për të përballuar varfërinë energjetike në vend. Andaj, qëllimi i këtij dokumenti është të bëjë një analizë të gjendjes së varfërisë energjetike në Maqedoni dhe politikave të zhvilluara për trajtimin e problemit, për të hartuar rekomandime politike për përmirësimin e tyre drejtuar për aktorët relevant.

Metodologjia është bazuar në një pako resursesh primare (ligje, strategji, raporte vjetore dhe statistika) dhe sekondare (studime, artikuj në mediet). Struktura e dokumentit do të jetë në atë mënyrë që pas informacioneve hyrëse mbi varfërinë energjetike, do të analizohen politikat vendore dhe në një pjesë do të diskutohen çështjet e ndryshme problematike të varfërisë energjetike në Maqedoni. Në fund të dokumentit, do të ketë konkluzione dhe rekomandime. Ky kërkim është i

<sup>1</sup> Dokumentet kryesore energjetike të miratuar janë Ligji mbi energjinë miratuar në 2011, Strategjia për Zhvillimin Energjetik; Strategjia për Efikasitet Energjetik; dhe Strategjia për Energji të ripërtërishme, që të tre të miratuar në vitin 2010.

rëndësishëm sepse varfëria energjetike është një fenomen social-ekonomik që mesa duket përfshin një spektër më të gjerë të popullatës së vendit dhe hartimi i zgjidhjeve për përmirësimin e gjendjes është faktor kyç për zhvillimin e qëndrueshëm.

## TË KUPTUARIT E VARFËRISË ENERGETIKE

*Varfëria energjetike* është një term relativisht i ri posaçërisht në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe nuk ka një definicion të vetëm, mirëpo definicioni më i përshtatshëm për rastin e rajonit është ai që ka të bëjë me mungesën e ngrohjes adekuate nëpër shtëpitë. Për ta ilustruar më qartë, *varfëria energjetike përshkruhet si një gjendje në të cilën amvisëritë jetojnë me ngrohje të joadekuate nëpër shtëpitë, që nënkupton se temperatura mesatare ditore brenda shtëpisë ku jetojnë është nën kufirin e përcaktuar biologjikisht prej 21°C të nevojshëm për mirëmbajtjen e komfortit dhe shëndetit<sup>3</sup>, ose që shkalla e ngrohtësisë në shtëpinë është më e ulët nga minimumi subjektiv që mundëson një individ të zhvillojë jetën e përditshme në mënyrë të drejtë<sup>4</sup>. Një definicion tjetër që vlen për rajonin është si vijon: " *Varfëria energjetike ose e lëndëve djegëse në Ballkanin Perëndimor nuk është saktë mungesa e qasjes në infrastrukturë, por vështirësisë për mirëmbajtjen e ngrohtësisë së mjaftueshme me çmim të përballueshëm*".<sup>5</sup> Në kuptimin e njëjtë sikur varfëria energjetike, BE-ja përdor termin *konsumatorë të cenushtëm*<sup>6</sup> duke mos e definuar në pakon e tretë ligjore për tregun e brendshëm të gazit dhe energjisë elektrike,<sup>7</sup> pasi që konsiderohet si definicioni i drejtë meqë ky duhet të pasqyrojë tiparet kombëtare,<sup>8</sup> dhe si rrjedhoje kërkon të definohet në nivel kombëtar.*

**Nga definicionet e dhëna, qartë mund të vërehet që varfëria energjetike është lidhur ngushtë me:**

- **Mungesën e madhe të ngrohjes**

<sup>2</sup> Përkthimi i afërt i AMAN është: "It is enough".

<sup>3</sup> Boardman, Brenda, *Varfëria Energjetike: Prej shtëpive të ftohta deri në ngrohje me çmime adekuate*, (Londër, 1991)

<sup>4</sup> Stefan Bouzharovski, *Varfëria energjetike në tranzicion: Maqedonia dhe Republika Çeke në perspektivë komparative, Mendimi Politik, viti 8, nr. 29 (Shkup, 2010)*

<sup>5</sup> Pippa Gallop e tjerë, *Investoni me shpejtësi, pendohuni në kënaqësi*, (2013)

<sup>6</sup> Në literaturë konsumator përdoret njësoj sikur konsumator me domethënie e njëjtë.

<sup>7</sup> Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian L 211, Vëllimi 52, (2009).



- Amvisëritë
- Mungesën e mjeteve financiare për ngrohje

Të kuptohet varfëria energjetike nënkupton shpalesjen e shkaqeve për atë si dhe pasojat. Gjatë sistemit komunist, çmimet për energji elektrike në mënyrë artificiale janë mbajtur të ulëta, duke rezultuar me zgjerimin e energjisë elektrike për ngrohje dhe shkëputja masive nga ngrohja qendrore. Gjithashtu, ishte vërejtur një mbështetje e madhe në dru për djegie që veçanërisht përdorej në amvisëri me të ardhura të ulëta<sup>9</sup>. Me rënien e komunizmit në fillim të viteve 90-ta, filluan të paraqiten problemet me përballeshmërisë së energjisë elektrike. Në momentin kur vendet e Ballkanit Perëndimor filluan të transformojnë sistemet e tyre, energjia më nuk garantohej nga shteti por ishte transformuar në një mall, gjegjësisht një shërbim që mund të blihej në treg njësoj sikur mallrat tjera. Nuk duhet përmendet që situata bëhet më e ndërlikuar sepse energjia është një produkt pa të cilin jeta bashkëkohore të cilën neve e njohim nuk mund të paramendohet.

Trajtimi i varfërisë energjetike është i rëndësishëm sepse mungesa e ngrohjes adekuate ndikon mbi shëndetin dhe produktivitetin e popullatës. Në këtë drejtim, përdorimi i koftorëve joefikas me dru ka ndikim negativ mbi shëndetin e amvisërive për shkak të përdorimit të drunjve.<sup>10</sup> Gjithashtu, mungesa e investimeve në efikasitetin energjetik ka ndikime të mëdha mjedisore përfshirë edhe vdekjet të shkaktuara nga ndotja. Sipas Strategjisë Kombëtare për Mekanizmat e Zhvillimit të Pastër 2008-2012, sektori energjetik në Maqedoni ka kontribuar me rreth 70% të emisioneve të plota të gazrave të qelqta në vend.<sup>11</sup> Përveç kësaj, sipas Aneksit Statistikor për Zhvillim Njerëzor për vitin 2011, janë shkaktuar 148 vdekje për shkak të ndotjes së ajrit në atmosferë<sup>12</sup> për vitin 2004 në Maqedoni.<sup>13</sup>

<sup>8</sup> Komisioni Rregullator për Energji, *Trajtimi i konsumatorëve të cenusëshëm në Komunitetin Energjetik*, (2013)

<sup>9</sup> Stefan Bouzharovski e tjerë, *Qeverisja e varfërisë energjetike në Evropën Juglindore, Ifri*, (2011)

<sup>10</sup> IEA, *Energjia në Ballkanin Perëndimor Rruga për reforma dhe rindërtim*, (2008)

<sup>11</sup> UNDP, *Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Mekanizmit të Pastër për periudhën e parë të përkushtimit të Protokollit të Kjotos 2008 -2012*

<sup>12</sup> "Vdekjet nga ndotja e jashtme e ajrit" nënkupton vdekje për shkak të infektiveve dhe sëmundjeve të frymëmarrjes, kancer të mushkërive dhe sëmundje tjera kardiovaskulare që shkaktohen nga ndotja e ajrit.

*Nga ajo që është prezantuar, vërehet qartë se shkak për varfërinë energjetike është çmimi i ulët artificial për energji elektrike që ka shkaktuar përdorimin e gjerë të ngrohjes me rrymë, shkëputja nga ngrohja qendrore dhe praktikat e padrejta të konsumimit të energjisë; që ishin të shkaktuara nga rritja e çmimeve të energjisë elektrike, duke lënë konsumatorët me mjete të kufizuara financiare, mënyra të kufizuara për ngrohje (nuk ka alternativa për ngrohje si gaz natyral, vetëm zgjedhjen e mundshme të bio-masës) dhe konstruksione joeficiente të shtëpive në kuptim të kursimit energjetik.*

## POLITIKA PËR TRAJTIMIN E VARFËRISË ENERGIKE NË MAQEDONI

### Shembulli 1: Trazirat masive shoqërore në Maqedoni me emrin AMAN

Më 14 gusht 2012 filluan protestat më masive shoqërore në Maqedoni që përbëheshin prej më tepër se 10 000 qytetarë që protestuan kundër rritjes të çmimeve të energjisë elektrike dhe kundër keqësimit të standardit të jetesës. Protestat zgjatën pesë muaj dhe në ndërkohë filloi një iniciativë qytetare me më tepër se 13 000 nënshkrime për ndryshimin e Ligjit për Energji.<sup>14</sup> Me amendamentet e paraqitura bëheshin dy kërkesa: rikthimi i tarifave të lira të energjisë elektrike në kohëzgjatje prej 3 orëve gjatë ditëve për amvisëritë dhe lirimi i konsumatorëve të shkëputur nga obligimi për të paguar rimbursim për energji elektrike, ngrohje ose shërbime të gazit natyror nëse shkyçen. Qëllimi kryesor i propozim ligjit ishte mbrojtja e të drejtave ekonomike të qytetarëve.<sup>15</sup> Propozim ligji nuk morri mbështetjen nga

<sup>13</sup>Aneksi Statistikor i Zhvillimit Njerëzor, *faqe 151, Tabela 7. Internet faqja e UNDP*

[http://hdr.undp.org/en/media/HDR\\_2011\\_EN\\_Tables.pdf](http://hdr.undp.org/en/media/HDR_2011_EN_Tables.pdf)  
kontrolluar herën e fundit më 22.09.2013

<sup>14</sup> *Internet faqja e AMAN/ AMAN IT IS ENOUGH! Një vit nga protestat më masive sociale në Maqedoni*  
[http://amanmk.files.wordpress.com/2013/08/972361\\_31519573\\_5291058\\_167720378\\_n.png](http://amanmk.files.wordpress.com/2013/08/972361_31519573_5291058_167720378_n.png) kontrolluar herën e fundit më 22.09.2013

<sup>15</sup> *Internet faqja e Analytica/ Analytica komenton në propozim ligjin që ndryshon Ligjin për Energji që ishte paraqitur para iniciativës së qytetarëve AMAN*  
[http://www.analyticamk.org/index.php?option=com\\_content&view=article&id=333:analytica-commenting-on-the-draft-law-amending-the-energy-law-submitted-by-the-citizens-initiative-aman&catid=52:energy-and-infrastructure&Itemid=167](http://www.analyticamk.org/index.php?option=com_content&view=article&id=333:analytica-commenting-on-the-draft-law-amending-the-energy-law-submitted-by-the-citizens-initiative-aman&catid=52:energy-and-infrastructure&Itemid=167)  
kontrolluar herën e fundit më 22.09.2013



Parlamenti.<sup>16</sup> Protesta shoqërore AMAN ishte i pari prej këtij lloji dhe të këtij proporcioni në të gjithë territorin e Maqedonisë që dëshmoi se rritja e çmimeve të energjisë elektrike është çështje serioze që duhet të trajtohet nga autoritetet përkatëse si dhe një dëshmi që rritja e çmimeve të energjisë elektrike ndikon pjesën më të madhe të popullatës për dallim nga ajo që ishte vlerësuar fillimisht.

Maqedonia është nënshkruese e Memorandumit për Mirëkuptim për Çështje Sociale në kuadër të Komunitetit Energjetik që simbolizon synimin politik për të marrë në konsideratë dimensionin social të Traktatit të Komunitetit Energjetik<sup>17</sup> përfshirë edhe njohjen që konsekuencat më të mëdha sociale nga zbatimi i këtij Traktati duhet të mënjanohen.<sup>18</sup> Kjo krijoi bazën ligjore për zhvillimin e konceptit të varfërisë energjike në legjislaturën vendore për ndërmarrjen e masave mbrojtëse kundër varfërisë energjetike.

Maqedonia, bashkë me Shqipërinë janë vendet e vetme të Ballkanit Perëndimor që nuk kanë definicion për konsumator të cenueshëm në dispozitat e tyre ligjore.<sup>19</sup> Në Maqedoni nuk ekziston ndonjë ligj specifik ose akt nënligjor dedikuar *varfërisë energjetike*. Termi *varfëri energjetike* përdoret shpeshherë në ligjet ekzistuese mbi energjinë; mirëpo, termi *konsumatori social i cenueshëm* ose *konsumatori* gjithashtu përdoren në literaturë dhe dispozitat ligjore të vendit. Ligji mbi Energjinë i vitit 2011 përmend varfërinë energjetike në Nenin 9 në të cilin shkruan që politikat energjetike duhet të mundësojnë

<sup>16</sup> *Panta Dzambazoski, Telma*, Parlamenti ka refuzuar iniciativën e AMAN nga 13.02.2013, *Internet faqja e Telma* <http://telma.com.mk/index.php?task=content&cat=1&rub=15&item=24135> kontrolluar herën e fundit më 22.09/2013

<sup>17</sup> Traktati i Komunitetit Energjetik ka për qëllim të organizojë marrëdhëniet mes palëve dhe të krijojë korniza ligjore dhe ekonomike për të krijuar një sistem rregullator të qëndrueshëm dhe kornizë tregu të aftë për të tërhequr investimet në rrjetet e gazit, gjenerimin e energjisë dhe rrjeteve për transmetimin dhe shpërndarjen për të përmirësuar sigurinë e furnizimit dhe përmirësimin e situatës me mjedisin jetësor. Maqedonia ka ratifikuar Traktatin në vitin 2006 me ligj. Obligimet kryesore sipas këtij Traktati janë të zbatohen ligje evropiane specifike për energjinë. Ky Traktat parashikon liberalizimin e tregut për gjithë konsumatorët jashtë amvisërive prej 1 janar 2008 dhe liberalizim të tregut për gjithë konsumatorët prej 1 janar 2015. Internet faqja e Komunitetit energjetik/Traktatit "[http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC\\_HOME/ENERGY\\_COMMUNITY/Legal/Treaty](http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/ENERGY_COMMUNITY/Legal/Treaty)" kontrolluar herën e fundit më 22.09.2013

<sup>18</sup> *Komuniteti Energjetik*, Memorandum Mirëkuptimi për Çështje Sociale në kontekst të Komunitetit Energjetik, (*Vjenë, 2007*).

masa inter alia për të mbrojtur qytetarët ndaj varfërisë energjetike<sup>20</sup>. Në ligjin e përmendur, një nen i plotë i është kushtuar varfërisë energjetike:

Neni 14: "Me qëllim të zbatimit të mbrojtjes sociale të qytetarëve ndaj varfërisë energjetike, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në kërkesë të Ministrisë dhe në bashkëpunim me zyrtarin ministror përgjegjës për çështje sociale, ka miratuar programin vjetor për zvogëlimin e varfërisë energjetike në të cilën, mes tjerash, janë mundësuar: subvencione për konsumimin e energjisë elektrike dhe për burime energjetike për amvisëritë e ndara; llojet e energjisë dhe burimeve energjetike të cilat do të mbuloohen me subvencionim; përdorimi më efikas i energjisë, mënyrat e zbatimit të masave, burime buxhetore dhe masa tjera financimi; dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e masave."<sup>21</sup>

Në lidhje me masat konkrete kundër varfërisë energjetike, në vitin 2010, subvencioni për konsumimin e energjisë elektrike (rrymë, dru për djegie, thëngjill, vaj i lehtë për ngrohje në amvisëri/vaj për amvisëri dhe ngrohje qendrore) ishte prezantuar në vlerë mujore prej 600 denarëve (9.8 EUR) që ishin synuar për amvisëritë që përdorin ndihmë sociale dhe ndihmë të përhershme financiare. Kriteret për zgjedhje thonë që konsumatorët duhet të paguajnë për energjinë e konsumuar gjatë kohëzgjatjes së programit dhe që do të humbin të drejtën për këtë subvencion nëse nuk janë më përdorues të ndihmës sociale ose ndihmës së përhershme financiare. Masa zbatohet nga Ministria për Punë dhe Politikë Sociale dhe Qendrat për Punë Sociale; shumica e plotë e dhënë për vitin 2010 për mbështetjen e kësaj masa ishin 104.4 milion denarë (1,7 milion EUR) dhe kanë ardhur nga buxheti shtetëror.<sup>22</sup> Kjo masë vazhdoi edhe në vitin 2011<sup>23</sup> dhe në gjysmën e parë të vitit

<sup>19</sup> *Komisioni Rregullator për Energjetik*, Trajtimi i konsumatorëve të prekshëm në Komunitetin Energjetik, (2013)

<sup>20</sup> *Ligji mbi Energjinë*, *Gazeta Zyrtare* 16/11, Neni 9

<sup>21</sup> *Ibid.*, Neni 14

<sup>22</sup> *Programi për subvencionimin e Konsumimit Energjetik*, *Gazeta Zyrtare* 113/10

<sup>23</sup> *Programi për subvencionimin e Konsumimit Energjetik*, *Gazeta Zyrtare* 6/11



2012<sup>24</sup>. Prej gusht të vitit 2012 shuma mujore prej 600 denarëve ishte rritur në 700 denarë (11.4 EUR).<sup>25</sup> Subvencioni me shumë të rritur prej 700 denarëve në muaj vazhdoi edhe në vitin 2013; shuma e plotë për 2013 është 74 milion denarë (1,2 milion EUR) të siguruar nga buxheti shtetëror<sup>26</sup>. Publikimi i informacioneve për rritjen e subvencioneve për varësi energjetike në 700 denarë nga ana e ministrave të punës dhe ekonomisë ishte shoqëruar me sqarimin që nga ky subvencion rreth 20 000 amvisëri kanë përfituar deri më tani dhe që me këtë subvencion të rritur amvisëritë mund të mbulojnë rreth 170 KWh rrymë, ose rreth 50% të konsumimit total.<sup>27</sup>

Në strategjitë energjetike gjithashtu bëhet referencë për varfërinë energjetike, gjegjësisht për konsumatorët social të cenueshëm. Nuk është përcaktuar saktë për të varfrit nga energjia ose konsumatorët e cenueshëm, megjithatë bëhet njohje e problemit të varfërisë energjetike dhe diskutohet një pako masash për zgjidhjen e problemit. Në fillim, një prej prioriteteve për të arritur qëllimin kryesor të Strategjisë për Zhvillim Energjetik është që të përgatitet dhe zbatohet programi për mbështetjen e kategorisë sociale të konsumatorëve<sup>28</sup>, duke treguar që varfëria energjetike njihet si një çështje pozitive. Në këtë Strategji gjithashtu sqarohet që çmimi aktual i energjisë elektrike ka subvencionuar gjitha amvisëritë, që nënkupton se 20% prej të varfërve kane marrë vetëm 3% të subvencioneve.<sup>29</sup> Andaj, arritja e çmimit tregtar të energjisë elektrike është parakusht për inter alia prezantimit të gazit natyror nëpër amvisëritë, mbrojtje më të mirë të konsumatorëve social të cenueshëm dhe zvogëlimit të konsumimit të energjisë elektrike.<sup>30</sup>

<sup>24</sup> Programi për subvencionimin e Konsumimit Energjetik, Gazeta Zyrtare 8/12

<sup>25</sup> Programi për Ndryshimin e Programit për Subvencionimin e Konsumimit Energjetik për 2012, Gazeta Zyrtare 83/12

<sup>26</sup> Programi për Subvencionimin e Konsumimit Energjetik, Gazeta Zyrtare 4/13

<sup>27</sup> Ristovski dhe Sarachini: Rritja e subvencioneve për varfëri energjetike mund të mbulojë 50% të faturave nga 09.06.2012, Internet faqja e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë <http://www.vlada.mk/node/3439> kontrolluar herën e fundit më 22.09.2013.

<sup>28</sup> Ministria e Ekonomisë së Republikës së Maqedonisë, Strategjia për Zhvillimin e Energjisë e Republikës së Maqedonisë deri 2030 (Shkup, 2010)

<sup>29</sup> Ibid; Banka Botërore, Raporti nr. 48983-MK, Analiza të Politikave Energjetike në IRJ Maqedoni (Draft), (2009)

<sup>30</sup> Ministria e Ekonomisë së Republikës së Maqedonisë, Strategjia për Zhvillimin e Energjisë e Republikës së Maqedonisë deri 2030 (Shkup, 2010)

Në Strategjinë për Zhvillim Energjetik përmenden dy modelet për mbështetjen e konsumatorëve social të cenueshëm në kuptim të energjisë elektrike: bllok tarifave dhe subvencione të targetuara. Bllok tarifave mundësojnë çmim të ulët të energjisë elektrike (nën kostot e vërtetë) për amvisërisë sociale të prekshme të cilët do të kompensohen me çmime më të larta të energjisë elektrike të paguar nga konsumatorët tjerë. Ana pozitive e këtij modeli është që nuk ka nevojë për financa plotësuese; ajo negative është që kategoria e konsumatorëve tjerë mund të paguajnë çmime më të larta të rrymës. Subvencionet e targetuara janë në formë të kuponëve me të cilat konsumatorët social të cenueshëm paguajnë për energjinë elektrike. Ana pozitive është që kjo lloj ndihme drejtpërdrejtë targeton konsumatorët më të varfër dhe nuk ka çmim tjetër për kategoritë tjera të qytetarëve; ndërsa ana negative është që ky mekanizëm kërkon financa plotësuese nga buxheti. Një mangësi për dy modelet është identifikimi objektiv i konsumatorëve social të cenueshëm. Me Strategjinë rekomandohet edhe një model i dytë me dallimin që në vend të kuponëve, llogaritë do të subvencionohen drejtpërdrejtë me fonde buxhetore për përdoruesit e ndihmës sociale. Përveç kësaj, në Strategjinë rekomandohet që shteti të financojë përmirësimin e efikasitetit energjetik në amvisëritë e konsumatorëve social të cenueshëm, si dhe të përmirësohet efikasiteti energjetik i amvisërive që bëjnë pjesë në klasën e mesme për të parandaluar keqësimin e standardit të jetës së tyre. Në Strategjinë vlerësohet që 15-20 milion EUR të buxhetit duhen të shpenzohen për realizimin e programit për energji sociale.<sup>31</sup>

Në Programin për Realizimin e Strategjisë për Zhvillimin e Energjisë, që është plani i veprimit për Strategjinë për Zhvillimin e Energjisë, propozohet një pako më e ndërlikuar e masave për të ndihmuar konsumatorët social të cenueshëm. Një prej masave është përgatitja e një programi subvencionimi për zëvendësimin e koftorëve të vjetër dhe blerja e koftorëve të rinj më efikas, special për amvisëritë sociale të prekshme, do të zhvillohej gjatë periudhës 2012-2013 dhe është përgjegjësi e Ministrisë së Ekonomisë. Në Strategjinë gjithashtu planifikohet rritja e subvencionit për Programin për Subvencionimin e Konsumimit të Energjisë Elektrike. Disa prej masave tjera



të planifikuara janë edukimi dhe promovimi i efikasitetit energjetik, mbështetja financiare për amvisëritë e gatshme të investojnë në efikasitetin energjetik, ulja e tatimeve për investime në fushën e efikasitetit energjetik si koftorë efektiv me bio-masë, kolektorë dielli, etj.<sup>32</sup> Strategjia për Energji të Ripërtërishme nuk e zbërthen problemin e varfërisë energjetike në detaje, megjithatë kur shqyrtohet opsioni me bio-masë, përmendet që duhen të ofrohen subvencione për zëvendësimin e koftorëve të vjetër dhe të blihen koftorë të rinj më efikas, apostafat për amvisëritë sociale të prekshme.<sup>33</sup>

Strategjia për Efikasitet Energjetik nga ana tjetër më tepër kushton vëmendje konsumatorëve social të cenueshëm. Aty qartë identifikohet efikasiteti energjetik si një masë optimale për uljen e varfërisë energjetike. Masat sociale të planifikuara janë përmirësimi i efikasitetit energjetik në shtëpitë sociale, bllok tarifa për energji elektrike, si dhe instalimi i matësve për ngrohjen qendrore, zëvendësimi i koftorëve me dru me koftorë efikas energjetik, sisteme diellore, prezantimi i kodeve energjetike për ndërtesa dhe tjera. Shtëpive sociale ju jepet prioritet i lartë në këtë Strategji. Qeveria do të merr rolin kryesor në zbatimin e kësaj Strategjie dhe mjetet do të sigurohen inter alia nga Fondi për Efikasitet Energjetik.<sup>34</sup>

Në Planin e Veprimit për Efikasitet Energjetik theksohet qartë se ndihma sociale e targetuar për qytetarët me të ardhura të ulëta dhe konstruksioni i shtëpive sociale për amvisëritë më të prekshme është një zgjidhje më e përshtatshme për përdorimin e energjisë në planin afatgjatë për dallim nga subvencionet. Në këtë dokument propozohet edhe një projekt ambicioz – prej 7000 shtëpi sociale deri më 2020 me masa të aplikuara për efikasitet energjetik për amvisëritë sociale të prekshme. Me këtë Plan Veprimi planifikohet edhe miratimi i akteve sekondare ligjore për efikasitet energjetik në sektorin e ndërtimitarisë. Me prezantimin e koftorëve të rinj me efikasitet të lartë do të zvogëlojë konsumimin e drunjëve

për ngrohje. Në Planin e Veprimit gjithashtu theksohet për nevojën e ngritjes së nënvetëdijes me anë të fushatave informative për masat e përmirësimit të efikasitetit energjetik. Në formë të financave, masat e planifikuara janë subvencione për kolektorë solar dhe themelimi i Fondit për Efikasitet Energjetik.<sup>35</sup>

### **Shembulli 2: Dështimi i propozim Ligjit për Mbrojtje Sociale kundër Varfërisë Energjetike**

Në vitin 2008, nga një grup i anëtarëve të parlamentit ishte ndërmarrë një iniciativë për hartimin e një ligji të quajtur propozim Ligji për Mbrojtje Sociale kundër Varfërisë Energjetike. Megjithatë, ligji nuk kaloi<sup>36</sup> dhe që prej atëherë nuk ka pasur ndonjë propozim të ngjashëm në Parlament. Në hollësi, në Ligjin kishte fakte vijuese:

- Varfëria energjetike ishte definuar si një pamundësi për të mbuluar shpenzimet mujore për sasi të mujore të distribucionit të energjisë elektrike.
- Qëllimi i këtij propozim ligji është mbrojtja e qytetarëve më të varfër të vendit nga shoku i çmimit pas deklarimit të rritjes së çmimeve për rrymë elektrike. Masat në këtë ligj paramendoreshin të subvencionojnë konsumimin mujor të energjisë elektrike deri më 300 KWh dhe të mundësohet që amvisëritë të plotësojnë nevojat e tyre elementare. Amvisëritë që janë lëndë e këtij ligji kanë konsumim të rritur të energjisë elektrike gjatë sezonit të ngrohjes sepse ata përdorin kryesisht rrymën për ngrohje në mungesë të alternativave tjera për ngrohje. Këto amvisëri nuk mund të paguajnë faturat e tyre të rrymës elektrike, andaj kompania i shkyç; dhe jetesa pa energji elektrike nuk konsiderohet si e pranueshme.
- Ky propozim Ligji për Mbrojtje Sociale kundër Varfërisë Energjetike është bazuar në këto parime: ligjshmëri; siguri sociale; drejtësi sociale; humanizëm.

<sup>31</sup> Ibid.

<sup>32</sup> Akademia e Arteve dhe Shkencës, Programi për Realizimin e Strategjisë për Zhvillimin e Energjisë në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2012-2016, (Shkup, 2012)

<sup>33</sup> Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Ekonomisë, Strategjia e përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë në RM deri në vitin 2020, (Shkup, 2010)

<sup>34</sup> Ministria e Ekonomisë së Republikës së Maqedonisë, Strategjia për Zhvillimin e Energjisë e Republikës së Maqedonisë deri 2030 (Shkup, 2010)

<sup>35</sup> Plani i Parë i Veprimit për Efikasitet Energjetik 2010-2018, (Shkup, 2010)

<sup>36</sup> Netpres, DNEVNIK: Parlamenti nuk ka mbështetur Ligjin për Mbrojtje kundër Varfërisë Energjetike nga 19.11.2008, Internet faqja e Netpress [http://www.netpress.com.mk/mk/vest.asp?id=44475&kategorija=Z\\_kontrolluar\\_heren\\_e\\_fundit\\_më\\_23.09.2013](http://www.netpress.com.mk/mk/vest.asp?id=44475&kategorija=Z_kontrolluar_heren_e_fundit_më_23.09.2013)





- Marrësit e pranueshëm të masave për mbrojtje sociale kundër varfërisë energjetike janë: 1) amvisëritë që janë pranuese të ndihmës sociale, 2) amvisëritë që nuk kanë të punësuar asnjë anëtar të familjes, nuk janë pranues të ndihmës sociale dhe nuk kanë burime tjera të të ardhurave, 3) amvisëri që kanë anëtarë të papunësuar që pranon ndihmë të papunësisë, që ka burimin e vetëm të të ardhurave për amvisërinë; 4) amvisëri që përbëhet prej më tepër se dy anëtarëve prej të cilëve njëri është pensioner me pension minimal dhe që ka atë burimin e vetëm të të ardhurave për amvisërinë; dhe 5) amvisëri të përbërë nga më tepër se dy anëtarë dhe që ka një të punësuar me rrogë minimale dhe që është burimi i vetëm i të ardhurave për amvisërinë.
- Implikimet financiare të këtij propozim ligji ishin vlerësuar në 1.563.219.427 denarë ose rreth 25 milion EUR të cilat do të siguroheshin nga buxheti shtetërorë nëpërmjet Ministrisë së Financave.<sup>37</sup>

#### **Analiza e Analytica-s për këtë propozim ligj:**

Ndonëse paraqet një iniciativë e dështuar, një tentativë e parë ligjore për të trajtuar çështjen e varfërisë energjetike në mënyrë më serioze që do të ishte një ligj specifik dedikuar varfërisë energjetike dhe përcaktimin e amvisërive sociale të prekshme dhe varfërinë energjetike; është një iniciativë që ia vlen të komentohet. Nga këndvështrimi social, me propozim ligjin është përfshirë një spektër më i gjerë i amvisërive të ndikuara nga varfëria energjetike; megjithatë ndjek vije pas varfërisë në të ardhura, jo përshtatshmërinë e kushteve për ngrohje. Nga këndvështrimi ekonomik, është një subvencion që targeton amvisëritë dhe rrymën elektrike, fusha të cilat veçse janë të subvencionuara nga çmimi depresiv i energjisë elektrike; madje me këtë ligj inkurajohet përdorimi i rrymës elektrike për ngrohje; dhe si subvencion nuk motivon zbatimin e masave për efikasitet energjetik dhe as nuk shpie drejt uljes së konsumimit të energjisë elektrike.

#### **ÇËSHTJET E IDENTIFIKUARA**

Në pjesën vijuese, analiza do të përqendrohet në aspektet kryesore problematike të varfërisë energjetike

në Maqedoni duke filluar me praktikën të cilat i kontribuojnë keqësimin të situatës së varfërisë energjetike, veprimet që shkaktohen nga ajo dhe aspektet të cilat duhet të merren parasysh gjatë krijimit të masave për trajtimin e varfërisë energjetike.

#### **- Niveli i qytetarëve të ndikuar nga varfëria energjetike**

Grupi synues i Programit për Subvencionimin e Konsumimit të Energjisë Elektrike është shumë i ngushtë, duke përfshirë vetëm pranuesit e ndihmës sociale dhe ndihmës së përhershme financiare sipas logjikës që ata janë personat e varfër me energji. Stefan Bouzarovski vlerëson që ky Program është me drejtim të gabuar sepse nuk arrin të mundësojë një qasje sistematike që do të trajtonte faktorët e vërtetë të prekshmërisë energjetike, dhe me këtë duhej të zhvillohen kritere tjera për grupin synues. Gjithashtu, duhet të ketë një definicion më të rreptë dhe më përfshirës të prekshmërisë energjetike, të ndërlidhur me një pako gjithëpërfshirëse të indikatorëve, mekanizmave për monitorim dhe vlerësim.<sup>38</sup>

Jo vetëm në rastin me Maqedoninë, në përgjithësi është vështirë të vlerësohet spektri i prekshmërisë energjetike, që gjithashtu, siç përmendëm më para, është një çështje që mbetet të definohet në nivel kombëtar, një prej arsyeve përse konsumatorët social të cenueshëm nuk janë të përcaktuar në nivelin e BE-së. Megjithatë, për të luftuar në mënyrë efektive varfërinë energjetike, spektri i amvisërive të prekura nga varfëria energjetike duhet të mësohet.

Për të matur varfërinë energjetike, një ide është të ndiqet supozimi që popullata që jeton nën pragun kombëtar të varfërisë është ekspozuar varfërisë energjetike. Mirëpo, hulumtimet më të reja tregojnë që numri i konsumatorëve të ekspozuar në varfërinë energjetike është dukshëm më i madh. Kjo ndjehet më tepër në rastin me Maqedoninë sipas të dhënave nga Enti Shtetëror për Statistikë që prezanton mendimin subjektiv të qytetarëve për mundësinë e tyre të mbajnë shtëpitë të ngrohura në mënyrë adekuate. Jo vetëm që ky numër është shumë më i madh sesa nga të dhënat e shprehura

<sup>37</sup> Grup i anëtarëve të Parlamentit, Propozim ligji për mbrojtje sociale kundër varfërisë energjetike, (Shkup, 2008)

<sup>38</sup> Stefan Bouzharovski e tjerë, Qeverisja e varfërisë energjetike në Evropën Juglindore, Ifri, (2011)



mbi varfërinë (30.4% ishte përqindja e personave të varfër në vitin 2011<sup>39</sup>); por, me kalimin e viteve përqindja e amvisërive që kanë mundësi të mbajnë shtëpitë e tyre të ngrohta gradualisht ka rënë: 58,4% në 2009<sup>40</sup>, 52,6% në 2010<sup>41</sup>, 52% në 2011<sup>42</sup> dhe 51,6% në 2012<sup>43</sup>. Duke marrë parasysh marrëdhëniet e ndërlidhura mes varfërisë dhe papunësisë, e drejtë është të konstatohet që në vitin 2012 përqindja e papunësisë së popullatës prej moshës 15 vjeç e më lartë ishte 31%.<sup>44</sup> Të dhënat e prezantuara statistikore tregojnë që situata me sigurimin e nevojave elementare, përfshirë edhe energjinë, është jashtëzakonisht alarmante, duke ndikuar një pjesë të madhe të popullatës. Sipas një studimi, varfëria energjetike në Maqedoni mund të jetë deri më 61% e të gjitha amvisërive në vend<sup>45</sup>.

Përveç kësaj, për të përcaktuar saktë llojin e amvisërive të ndikuara nga varfëria energjetike, duhet të identifikohen të gjitha profilet e prekshmërisë energjetike. Sipas Entit Shtetëror të Statistikës, grupet më të prekshme ndaj varfërisë së përgjithshme, sipas profilit, janë amvisëritë me më shumë anëtarë, duke marrë parasysh faktin që 48.5% të personave të varfër jetojnë në amvisëri me 5 apo më shumë anëtarë.<sup>46</sup> Një studim tjetër prezanton profile më precize të të varfërve për energji: grupi i parë përbëhet nga grupet me të ardhura të ulëta si marrësit e ndihmës sociale, amvisëritë në krye me të rritur të papunësuar, amvisëritë me shumë fëmijë dhe familjet që varen nga bujqësia për të ardhurat e tyre. Grupi i dytë janë kryesisht pensionerë dhe familje me fëmijë të vegjël, të cilët ndikohen nga varfëria energjetike kryesisht për shkak të efikasitetit të dobët energjetik në shtëpitë e tyre. Kjo tregon që varfëria energjetike prek si amvisëritë e klasës së ulët ashtu edhe

atë të mesmen në të gjithë territorin.<sup>47</sup> Një fakt interesant është që grupi i dytë i amvisërive zakonisht nuk përcaktohet si grupi i varfër.

#### - Subvencionet ndaj efikasitetit energjetik

Nëpër gjitha literaturat zhvillohen diskutime të ndryshme mbi efektivitetin dhe implikimet e masave kundër varfërisë energjetike. Drejtimi kryesor i diskutimit është nëse të vazhdohet me subvencione ose të bëhen investime produktive në efikasitet energjetik. Momentalisht, masa kryesore në Maqedoni është subvencioni që është kritikuar mjaft sepse nuk mbështet efikasitetin energjetik, përkundrazi, mbështet amvisëritë me ardhura të ulëta që të përdorin energjinë elektrike,<sup>48</sup> dhe një argument i ngjashëm ishte bërë nga USAID-i gjatë vlerësimit të këtij subvencioni, që është një masë që konsumatorët do të kanë pak nxitje të kursejnë energji elektrike, edhe pse si masë mundëson lehtësimin e menjëhershëm të amvisërive të prekura.<sup>49</sup> Zgjidhja e sugjeruar nga USAID-i është sigurimi i ndihmës duke propozuar një program efikas energjetik me çmime të ulëta të cilat do të synohen për faturat e familjeve të varfra duke instaluar sisteme për efikasitet energjetik me kosto të ulëta. Këto masa për efikasitet energjetik si sigurimi i izolimit për shembull do të bëhej falas. Ky lloj i masës është më efektiv nga kostoja dhe më kursyes për dallim nga subvencionet sepse programi për efikasitet energjetik do ti jepej amvisërisë vetëm njëherë; me këtë përmirësohet komforti si dhe efikasiteti energjetik. Ky program për energji efikas me kosto të ultë vlerësohet nga USAID-i si esenciale sepse bregat mbi lejueshmërinë e energjisë elektrike përdoret si arsye për të mbajtur tarifat energjetike në nivelet e kostove për rimarrje. Kostoja vjetore për këtë masë vlerësohet të jetë prej 250,000 dollarë (184 711 EUR) - 1 milion dollarë (738 847 EUR).<sup>50</sup>

Ky konstatim gjithashtu përputhet edhe me mendimin e Komunitetit Energjetik që thekson se konsumatorët e cenueshëm nga varfëria energjetike duhen të sigurohen duke ju ofruar skema të nevojshme për mbrojtje por pa

<sup>39</sup> Enti Shtetëror i Statistikës, deklaratë për shtyp, Varfëria relative në 2011 Nr: 4.1.12.50, (2012)

<sup>40</sup> Enti Shtetëror i Statistikës, Konsumimi i amvisërive në Republikën e Maqedonisë, 2009, (Shkup, 2010)

<sup>41</sup> Enti Shtetëror i Statistikës, Konsumimi i amvisërive në Republikën e Maqedonisë, 2010, (Shkup, 2011)

<sup>42</sup> Enti Shtetëror i Statistikës, Konsumimi i amvisërive në Republikën e Maqedonisë, 2011, (Shkup, 2012)

<sup>43</sup> Enti Shtetëror i Statistikës, Konsumimi i amvisërive në Republikën e Maqedonisë, 2012, (Shkup, 2013)

<sup>44</sup> Enti Shtetëror i Statistikës, Analizë e tregut të punës, 2012, (Shkup, 2013)

<sup>45</sup> Stefan Buzar, Varfëria Energjetike në Evropën Lindore: Gjeografitë e Fshehura të Mungesës, (2007)

<sup>46</sup> Enti Shtetëror i Statistikës, deklaratë për shtyp, Varfëria relative në 2011 Nr: 4.1.12.50, (2012)

<sup>47</sup> Stefan Bouzharovski, Varfëria energjetike në tranzicion: Maqedonia dhe Republika Çeke në perspektivë komparative, Mendimi Politik, viti 8, nr. 29 (Shkup, 2010)

<sup>48</sup> Stefan Bouzharovski e tjerë, Qeverisja e varfërisë energjetike në Evropën Juglindore, Ifri, (2011)

<sup>49</sup> USAID, Raporti Final i Vlerësimit për Efikasitetin Energjetik dhe Energjisë së Ripërtërishme në Maqedoni (2009)



trajtuar energjinë elektrike si kategori sociale me anë të tarifave të ulëta energjetike.<sup>51</sup> Përveç kësaj, një projekt tjetër që ishte zbatuar në Maqedoni gjatë vitit 2006-2007 me titullin Mbrojtja Sociale kundër Varfërisë Energjetike nga konsulenti Ramboll ka dhënë konkluzione të cilat janë në favor të zgjidhjeve më të qëndrueshme për varfërinë energjetike: familjet e varfra duhet të ndihmohen për të investuar në efikasitetin energjetik dhe me këtë të japin kontribut në uljen e faturave të tyre për energji elektrike dhe të mund të paguajnë faturat në të ardhmen; dhe krijimi i një fondi për të financuar investimet për të përmirësuar efikasitetin energjetik si masë kundër varfërisë energjetike.<sup>52</sup>

**- Zbatimi i masave të planifikuara kundër varfërisë energjetike**

Siç kemi vërejtur në strategjitë energjetike që janë në fuqi në Maqedoni, janë planifikuar pako të ndryshme të masave nga subvencioni i targetuar, prej projekteve të qëndrueshme për dru deri në ato për strehim. Megjithatë, vërehet qartë që vetëm subvencioni, gjegjësisht, Programi për Subvencionimin e Konsumimit të Energjisë është në fuqi. Për shembull, Ligji për Strehim Social, i hartuar në Strategjinë Kombëtare për Strehim 2007-2012<sup>53</sup> ende nuk është miratuar. Gjithashtu, nuk ka indikacione që masat tjera të planifikuara në strategjitë energjetike të vendit si përdorimi më i qëndrueshëm i drunjve, themelimi i Fondit për Efikasitet Energjetik, etj., janë duke u zbatuar.

**- Çmimi i energjisë elektrike dhe praktika të shpenzimit të kotë të energjisë**


Çmimet e rritura të energjisë elektrike duket të jenë një nga shtytësit për keqësimin e situatës me varfërinë energjetike. Ky proces është i lidhur me liberalizimin e tregut sipas të cilës çmimi i keq social i energjisë elektrike duhet të rritet për të arritur çmimin e tregut, duke u bërë barrë për shumë qytetarë, të cilët veçse janë të prekur nga varfëria dhe papunësia. Një studim identifikon që një prej shkaqeve kryesore për ndikimin

serioz të çmimeve të energjisë elektrike mbi popullatën është fakti që energjia e shpenzuar kot në rajon është tepër e madhe. Për ta ilustruar më mirë, në Maqedoni është e zakonshme që të përdoret për ngrohjen e dhomave, një mënyrë joefikase e përdorimit të energjisë, si dhe zakonisht përdorimi i ngrohjes në terraca të lokaleve gjatë dimrit të lidhura me rrymë ose me gaz. Zgjidhjet për këtë situatë në të cilën reformat për liberalizimin e tregut energjetik ende vazhdon dhe faturat për energji elektrike mbahen në nivel të caktuar janë orientuar në gjatjen e medies së pranueshme ku konsumatorët e pavetëdijshëm janë të nxitur të përdorin energjinë elektrike në mënyrë më efikase (matje, izolim, etj.), ndërsa konsumatorët e cenushtëm janë të mbrojtur në mënyrë adekuate dhe mund të fillojnë masa për kursimin dhe efikasitetin e energjisë elektrike.<sup>54</sup>

Si pasojë e një dekade të çmimit të ulët të energjisë elektrike, praktika të shumta të konsumimit kot të energjisë janë zhvilluar në mesin e popullatës. Sipas Entit Shtetëror të Statistikës konsumatorët më të mëdhenj të energjisë elektrike në vitin 2011 në Maqedoni ishin: industria me 32.78%, amvisëritë me 27.41% dhe transporti me 24.23%<sup>55</sup>, që tregon qartë se sektori i amvisërive është konsumatori i dytë i energjisë elektrike. Nëse analizohen amvisëritë si sektor i veçantë, në Figurën 1 është dhënë niveli i konsumimit në amvisëritë, tregohet që energjia elektrike përfshin shifrën mahnitëse prej 53% ndërsa ngrohja e krijuar është vetëm 6.8%<sup>56</sup>.

**Figura 1: Konsumimi i energjisë në amvisëritë sipas produkteve energjetike, 2011**

G-03: Финална енергетска потрошувачка во домаќинствата по видови енергенти, 2011<sup>1)</sup>  
G-03: Final energy consumption in households by energy commodities, 2011<sup>1)</sup>



<sup>50</sup> Ibid.

<sup>51</sup> Sekretariati i Komunitetit Energjetik, Raporti vjetor për zbatimin e të drejtës evropiane sipas Traktatit për themelimin e Komunitetit Energjetik, (2012)

<sup>52</sup> Komisioni Rregullator i Energjetikës në RM, Plane veprimi për të ulur varfërinë energjetike – eksperiencia e Republikës së Maqedonisë

<sup>53</sup> Ministria e Transportit dhe Lidhjes, Strategjia për strehim e Republikës së Maqedonisë 2007-2012, (2007)

<sup>54</sup> Pippa Gallop e tjerë, Investoni me shpejtësi, pendohuni në kënaqësi, (2013)

<sup>55</sup> Enti Shtetëror i Statistikës, deklaratë për shtyp Bilancet Energjetike, 2011, Nr: 6.1.12.82, (2012)

<sup>56</sup> Ibid.



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

- **Shkëputjet nga ngrohja qendrore dhe zmadhimi i përdorimit të ngrohjes me energji elektrike**

Siç ishte konstatuar, varfëria energjetike është ngushtë e lidhur me përdorimin e energjisë elektrike për ngrohje dhe për ngrohje qendrore. Kërkimet kanë treguar që as veglat për shpërndarjen e energjisë elektrike as kompanitë për ngrohje qendrore në Shkup nuk kanë arritur të zhvillojnë politika për trajtimin e çështjes së kalimit në ngrohje me energji elektrike dhe politika për mënjanimin e problemit për shkëputjen nga ngrohja qendrore. Në kohën e njëjtë, autoritet vendore, duke qenë të vetëdijshëm për këto çështje nuk kanë treguar asnjë iniciativë dhe udhëheqësi për të gjetur zgjidhje.<sup>57</sup>

Një dokument politik për tregun e ngrohjes në vend pohon që ajo karakterizohet me ngrohje qendrore të vogla dhe pak të zhvilluara (10% të konsumatorëve të ngrohjes janë të lidhur me ngrohje qendrore sipas Strategjisë për Zhvillimin Energjetik<sup>58</sup>) që gjendet në duart e një aktori dominues dhe forma individuale të ngrohjes. Gjithashtu, ngrohja me energji elektrike zakonisht përdoret në rajone urbane. Të dhënat nga ish kompania për ngrohje qendrore Toplifikacija Grupi tregojnë që konsumatorët me të mëdhenj ishin duke u shkëputur nga ngrohja qendrore e Toplifikacija: në vitin 2009 ishin bërë 1858 shkëputje dhe 491 lidhje të reja<sup>59</sup>, ndërsa në 2008, 315 konsumatorë janë lidhur sërish dhe 3132 ishin shkëputur.<sup>60</sup> Përveç kësaj, në dokument theksohet që lidhja ekzistuese e linjës së gazit nuk përdoret shumë, që përfaqëson një pengesë për përdorimin e gazit natyror nëpër shtëpitë dhe pengesë edhe për kompanitë për të depërtuar në tregun e ngrohjes. Një nga zgjidhjet që ky dokument propozon është ndërtimi i objekteve për kogjeneracion<sup>61</sup>, të cilat mund të bëhen një pjesë e rëndësishme e shërbimeve të ngrohjes qendrore dhe në përgjithësi të tregut të

ngrohjes. Disa prej përfitimeve nga kogjenerimi<sup>62</sup> janë ulja e emisioneve të CO<sub>2</sub>, përdorimi i mundshëm i lëndëve të ripërtërishme, efikasitet të lartë energjetik për shkak të përdorimit të njëkohshëm të lëndës së njëjtë për energji elektrike dhe ngrohje, përdorimi i tepricës së energjisë dhe zvogëlimi i kërkesës së energjisë primare.<sup>63</sup>

Më tepër, ngrohja qendrore u përball me zmadhimin e shkëputjeve të cilat janë të sqaruara me faktin që konsumimi filloi të matet në nivelin e banesave, gjegjësisht në ndërtesa me izolim të dobët – ose atë që një numër i madh i amvisërive kishin vendosur të shkëputen nga rrjeti – kishin kosto më të mëdha të njësisë, që mund të detyrojë më tepër amvisëri të shkëputen dhe që nga ana tjetër krijon një rreth të caktuar të shkëputjes.<sup>64</sup> Gjithashtu, mund të fajësohet edhe natyra e paqëndrueshme e furnizimit të energjisë elektrike që mund të vërehet nga praktikata e “dyfishimit” të konsumatorëve (p.sh. energji elektrike dhe dru). Gjatë periudhave të ftohta të dimrit, kur furnizimi i drunjve nuk mund të plotësojë nevojat e kërkesës, konsumatorët përdorin kaloriferët elektrik si zëvendësim, që shkakton ngarkime plotësuese të rrjeteve elektrike.<sup>65</sup>

- **Përdorimi i qëndrueshëm i bio-masës**

Siç përmendëm më parë, drunjte për djegie kanë luajtur një rol të rëndësishëm në tranzicionin energjetik të Maqedonisë duke u bërë burimi i ngrohjes për shumë familje. Të dhënat për vendin tregojnë që ka pasur rritje të madhe (44%) të përdorimit të bio-masës (shumica dru për djegie) mes viteve 1001 deri 2005, një fenomen që IEA-ja e vlerëson të jetë indikator për rritje të varfërisë energjetike, ndërsa kjo e shkaktuar nga rritja e çmimeve të energjisë.<sup>66</sup> Përdorimi aktual i bio-masës në Maqedoni është i lartë, që përfaqëson 9,5% të energjisë së harxhuar dhe 59% të lëndëve të ripërtrishme (të dhëna për vitin 2005), por më tepër përdoret për ngrohje sepse nga të dhënat statistikore mësojmë që bio-masa është

<sup>57</sup> Stefan Bouzharovski e tjerë, Qeverisja e varfërisë energjetike në Evropën Juglindore, Ifri, (2011)

<sup>58</sup> Ministria e Ekonomisë së Republikës së Maqedonisë, Strategjia për Zhvillimin e Energjisë e Republikës së Maqedonisë deri 2030 (Shkup, 2010)

<sup>59</sup> Toplifikacija AD Shkup, Raporti vjetor për vitin 2009

<sup>60</sup> Toplifikacija AD Shkup, Raporti vjetor për vitin 2008

<sup>61</sup> Kogjenerimi është gjenerimi i përnjëhershëm i energjisë elektrike dhe ngrohtësisë nga lënda e njëjtë.

<sup>62</sup> IEA, Kogjenerimi dhe lëndët e ripërtërishme. Zgjidhje për një ardhmëri me energji me karbon të ulët, (2011); IEA, Hartat teknologjike për ndërtesa efikase energjetike: Pajisje për ngrohje dhe ftohje, (2011); DHC+ Platforma teknologjike, Ngruhja/Ftohja Qendrore Një vizion drejt 2020-2030-2050, (2009)

<sup>63</sup> Ana Stojilovska, “Historia e tregut të ngrohjes në Maqedoni – si të bëjmë reformat?” Analytica, (2012)

<sup>64</sup> Stefan Bouzharovski e tjerë, Qeverisja e varfërisë energjetike në Evropën Juglindore, Ifri, (2011)

<sup>65</sup> IEA, Energjia në Ballkanin Perëndimor Rruga për reforma dhe rindërtim, (2008)

<sup>66</sup> Ibid.



burimi i ngrohjes për 430 000 amvisëri (76%). Gjithashtu, 80% të bio-masës të përdorur në Maqedoni është lloje të drurit për djegie.<sup>67</sup> Të përballur me çmime të larta të energjisë elektrike, shumë amvisëri i janë kthyer drurit, mirëpo përdorimi i tyre lidhet me problemin e njohur të prerjes së pyjeve dhe përdorimi i tyre për ngrohje dhe e gjithë kjo bëhet në mënyrë joefikase (nëse përdoret në koftorë të vjetër, ka më pak kalori sesa topthat – bio-masë nga mbetjet industriale të drurit, zakonisht mblidhet si rezultat i prerjes së paligjshme të drunjve, etj.).

Në këtë drejtim, koftorët joefikas për dru me efikasitetin e konvergjencës prej 20% ose më pak janë përgjegjëse për prerjen e pyjeve. Banka Botërore thekson që prezantimi i koftorëve efikas për ngrohje me dru për të zëvendësuar modelet e vjetra të koftorëve është një masë e rëndësishme për efikasitetin energjetik për rajonin që do të shpëtojë mjedisin jetësor, shëndetin njerëzor dhe do të nxitë përpjekjet kundër varfërisë.<sup>68</sup> USAID ka bërë sugjerime të ngjashme për përdorimin më të qëndrueshëm të bio-masës (mbeturinat nga pyjet, përpunimi i mobileve/pyjeve të vjetra, mbeturina nga vreshtaria dhe bujqësia) sepse me zhvillimin e ngrohjes me toptha të drurit, ngrohja me rrymë do të zvogëlohet. Studimi gjithashtu sugjeron që ka potencial të madh për përdorimin e ngrohjes së kombinuar me bio-masë dhe impiante energjetike në industrinë, spitalet dhe komunat të cilat mund të fillojnë si projekte lokale të komunave.<sup>69</sup>

#### - **Zbatimi i masave për efikasitetin energjetik dhe energjinë të ripërtërishme**

Varfëria energjetike mund të krijojë qarqe negative mes skemave të investimit, politikave dhe mungesave sociale, kjo ndodh për shkak se niveli i ngrohtësisë së dobishme nëpër shtëpitë është ndërlidhur me efikasitetin energjetik të objektit, instalimet për shpërndarjen e energjisë dhe aparatet shtëpiake. Andaj, skemat e varfërisë energjetike varen nga nivelet e investimeve dhe mirëmbajtjes së

<sup>67</sup> *Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Ekonomisë, Strategjia e përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë në RM deri në vitin 2020, (Shkup, 2010)*

<sup>68</sup> *Banka Botërore, Statusi i efikasitetit energjetik në Ballkanin Perëndimor, (2010)*

<sup>69</sup> *USAID, Raporti Final i Vlerësimit për Efikasitetin Energjetik dhe Energjinë së Ripërtërishme në Maqedoni (2009)*

këtyre stoqeve kapitale.<sup>70</sup> Në esencë, pjesa më e madhe e Evropës Juglindore dhe Lindore vuajnë nga varfëria energjetike, jo nga shkak që nuk mund të paguajnë faturat por për shkak të shtëpive me efikasitet të dobët dhe mungesa e investimeve në vendet tepër të ftohta ose tepër të ngrohta.

Siç është identifikuar në studimet ndërkombëtare dhe në ligjet e Maqedonisë, nuk mbetet mister që çelësi për luftimin e varfërisë energjetike qëndron në përmirësimin e efikasitetit energjetik. Maqedonia ka miratuar dokumentet kryesore energjetike, mirëpo është sfiduar gjatë zbatimit të tyre. Disa shembuj për të ilustruar këtë më mirë është që disa prej akteve nënligjore të rëndësishme në fushën e efikasitetit energjetik si Rregullorja për Tiparet Energjetike të Ndërtesave dhe Rregullorja për Kontrollin Energjetik<sup>71</sup> janë miratuar me vonesë sepse pritej që të miratohen më para amendamentet e Ligjit për Energjinë të muajit maj 2013. Gjithashtu, një prej instrumenteve kryesore financiare të planifikuar për të kontribuar në zbatimin e projekteve për efikasitetin energjetik, Fondi për Efikasitetin Energjetik, i planifikuar që prej vitit 2004 ende nuk është themeluar.

Mirëpo, shembull pozitiv është projekti i Ministrisë së Ekonomisë për të subvencionuar kolektorë solar që ishte zbatuar në vitet 2007, 2009, 2011, 2012 dhe 2013. Përfitimet pozitive financiare nga instalimi i kolektorëve solar janë kursime vjetore prej 13 344 denarë (217 EUR) për një amvisëri.<sup>72</sup> Kjo masë duhet të vazhdojë për të ngritur vetëdijen për efektet pozitive nga zëvendësimi i mënyrës konvencione të ngrohjes së ujit me energjinë diellore.

#### - **Planet dhe politikat për zhvillim lokal**

Zbatimi i efikasitetit energjetik nuk është vetëm obligim i shtetit por gjithashtu edhe i autoriteteve lokale, që vazhdojnë të vetëdijesohen mbi çështjet me të cilat ballafaqohen qytetarët dhe që mund të lëvizin zhvillimin lokal ekonomik. Sidoqoftë, komunat kanë vështirësi në përpilimin dhe zbatimin e programeve lokale për

<sup>70</sup> *Stefan Bouzharovski, Varfëria energjetike në tranzicion: Maqedonia dhe Republika Çeke në perspektivë komparative, Mendimi Politik, viti 8, nr. 29 (Shkup, 2010)*

<sup>71</sup> *Gazeta Zyrtare 94/13*

<sup>72</sup> *Milica Andonov, Ministria e Ekonomisë, Rezultate nga financimi i kolektorëve solar, Prezantimi në konferencën Financimi i efikasitetit energjetik dhe lëndëve të ripërtërishme, Java e energjisë në Maqedoni 2012*



efikasitet energjetik. Kjo qartë shihet nga të dhënat e mbledhura nga Agjencia Energjetike ku tregon se nga 80 komuna (para 2013 - 84) vetëm 32 kanë dorëzuar programet trevjeçare për efikasitet energjetik tek Agjencia Energjetike, nga të cilat vetëm 12 kanë pasur vlerësim pozitiv nga Agjencia.<sup>73</sup> Por, edhe programet e miratuara të komunave për efikasitet energjetik kanë numër të vogël të projekteve me energji të ripërtrishme dhe zakonisht ngurrojnë të ndërmarin projekte më të mëdha për efikasitet energjetik, sikur ndërtimi i mjeteve të vogla për kogjeneracion ose projekte gazifikimi. Këto plane komunale për efikasitet energjetik kryesisht përqendrohen në masa sikur përmirësimi i izolimit ose ndërtimi i poçeve elektrike.<sup>74</sup> Nga ana tjetër, ka pasur edhe shembuj pozitiv ku disa komuna kanë filluar projekte të vogla të gazifikimit lokal, duke synuar oferta më të mira për shërbimet e nxehtësisë.<sup>75</sup> Shembulli i fundit është një projekt në drejtimin e duhur, pasi që varfëria energjetike është afër e lidhur me kushtet e dobëta të nxehtësisë. Një pikë e përbashkët edhe për projektet e efikasitetit energjetik edhe të gazifikimit, të ndërmarra nga komunat është se target grupi i parë i tyre janë objektet publike, që domethënë se amvisëritë të fundit lidhen me rrjetin lokal të gazifikimit<sup>76</sup> dhe programet për efikasitet energjetik janë fillimisht, dhe para së gjitha të planifikuara për objektet publike nën përgjegjësinë e autoriteteve lokale<sup>77</sup>, dhe me këtë sektori i amvisërisë nuk është prioritet në reformat lokale energjetike.

#### - Ngritja e vetëdijes

Pasi që tregu energjetik maqedonas është duke kaluar nëpër procesin e tranzicionit, e njëjta ndodh edhe me praktikën dhe trajtimet e energjisë. Studimet japin prova për marrëdhënien mes mungesës së njohurive dhe praktikës së shpenzimit të kotë të energjisë. IEA konstaton se mungesa e njohurive dhe qasja ndaj informatave mund të shpijnë në zgjedhje jo-optimale. Sipas kësaj,

<sup>73</sup> Agjencia Energjetike e Republikës së Maqedonisë, Raporti vjetor për 2012, (2013)

<sup>74</sup> Plane lokale për efikasitet energjetik sikur ato të komunave të Manastirit, Gjevgjelijë, Çashkës, Kratovës dhe Tetovës.

<sup>75</sup> Ky ishte rasti me komunat e Karposhit, Strumicës dhe Kumanovës me projekte të avancuara me gazifikim lokal, sidoqoftë edhe shumë komuna tjera kanë paralajmëruar projekte të ngjashme.

<sup>76</sup> Pyetësor për komunat e Karposhit, Strumicës dhe Kumanovës, të plotësuar në janar dhe shkurt të 2013

amvisëritë e painformuara blejnë pajisje me cilësi të ulët ose lëndë djegëse që nuk janë efikase. Amvisëritë e varfra në Ballkanin Perëndimor harxhojnë një pjesë të madhe të të ardhurave të tyre në lëndë djegëse për nxehtësi dhe shërbime energjetike, që zakonisht është si rezultat i përdorimit joefikas të energjisë.<sup>78</sup> Ndaj, është shumë e rëndësishme që familjet e varfra të sigurohen me informata mbi mënyrat e kursimit të energjisë dhe integrimin e masave për efikasitet energjetik.

#### Shembulli 3: Pse ekziston varfëria energjetike në Maqedoni

- Të ardhura të ulëta
- Amvisëri energjetike joefikase
- Mungesë e zbatimit të politikave për efikasitet energjetik
- Rritje e çmimeve të energjisë
- Kufizim i alternativave tjera për nxehtësi
- Praktikën e harxhimit të kotë të energjisë në amvisëri
- Nuk ka definicion të varfërisë energjetike dhe shtrirje e ngushtë, e definuar e varfërisë energjetike

#### KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Ky dokument synon të analizojë gjendjen e varfërisë energjetike në Maqedoni dhe politikën përkatëse, me qëllim që të përpilohen zgjedhje më të mira. Varfëria energjetike si çështje veçse ka sfiduar shoqërinë e ndjeshme maqedonase në tranzicionin e ekonomisë së tregut dhe procesin e integritit evropian.

Varfëria energjetike si një fenomen socio-ekonomik ka ndikuar në një shtrirje më të gjerë të popullatës, se sa që është paraparë fillimisht me politikën e drejtuar kah kjo çështje, që shihet gjithashtu edhe me trazirat masive sociale, me protesta kundër rritjes së çmimit të energjisë. Varfëria energjetike nuk është e definuar në legjislaturën maqedonase, sidoqoftë, zhvillohet një subvencion për vetëm një grup të vogël të amvisërive të ndikuara nga ky problem. Strategjitë energjetike

<sup>77</sup> Kjo i përket për shembull planeve për efikasitet energjetik sikur ato të komunës së Manastirit, Gjevgjelijë, Çashkës, Kratovës dhe Tetovës.

<sup>78</sup> IEA, Energjia në Ballkanin Perëndimor, Rruga drejtë reformave dhe rikonstrukcionit, (2008)



parashohin shumë masa të mira kundër varfërisë energjetike sikur investimi në efikasitet energjetik, përdorimi i koftorëve me dru, përmirësimi i ngrohjes qendrore, etj. edhe pse ende nuk janë zbatuar. Sidoqoftë, strategjitë energjetike kanë një mangësi dhe kjo është vlerësimi i saktë i shtrirjes së pjesës së ndikuar të popullatës. Është e rëndësishme të theksohet se trajtimi i varfërisë energjetike në mënyrë joproduktive nëpërmjet subvencioneve nuk kontribuon në zgjedhjen afatgjatë të çështjes, pasi që nuk inkurajon kursimin e energjisë, braktisjen e nxehjes elektrike dhe zbatimin e masave për efikasitet energjetik. Ky problem i varfërisë energjetike kërkon një zgjedhje urgjente për shkak të liberalizimit të tregut energjetik që pritet në Evropën Juglindore dhe rritjen e mëtutjeshme të çmimit të energjisë elektrike. Siç u tha, investimi në efikasitetin energjetik është zgjidhja më efektive për varfërinë energjetike, që duhet zbatuar në mënyrën e duhur. Zgjidhja e çështjes së varfërisë energjetike është e rëndësishme për një drejtim të qëndrueshëm të vendit.

Pra, bazuar në analizat, rekomandohet që:

- **Ministria e Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikave Sociale dhe aktor të tjerë, sikur universitete, qendra hulumtuese, organizata të shoqërisë civile etj., të definojnë varfërinë energjetike dhe të përcaktojnë shtrirjen e të varfërve energjetik në Maqedoni, bazuar në përshtatshmërinë e kushteve të ngrohjes në hapësirat e amvisërive.**
- **Ministria e Ekonomisë duhet të sigurohet që të zbatohen masat e parapara për efikasitet energjetik, sikur përdorimi i koftorëve me dru, prezantimi i matësve në nxehjen qendrore, masa për efikasitet energjetik në familje me të ardhura të ulëta, etj., si dhe monitorim të këtij zbatimi.**
- **Ministria e Transportit dhe Komunikacionit në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe aktor të tjerë duhet të zbatojnë projekte për strehim social: të përgatisin Aktin mbi Strehimin Social dhe të sigurojnë që këto hapësira strehimi të kenë standardet më të larta të efikasitetit energjetik.**

- **Ministria e Ekonomisë, Ministria e Punës dhe Politikave Sociale duhet të pranojnë se masa më efikase dhe prioritare kundër varfërisë energjetike është investimi në efikasitet energjetik të amvisërive, për shembull duke ofruar përmirësim falas të efikasitetit energjetik të një amvisërie pasi që ta kenë vlerësuar shtrirjen e të varfërve energjetik në Maqedoni.**
- **Subvencioni për konsumimin energjetik gradualisht të zëvendësohet me masa të njëhershme për efikasitet energjetik në amvisëri të definuara si amvisëri të varfra energjetike, duke filluar me amvisëri me më shumë anëtar, amvisëri me pensionist, amvisëri me më shumë fëmijë, amvisëri me përdorues të ndihmës sociale, amvisëri të drejtuara nga anëtar të papunësuar, amvisëri të varura nga bujqësia dhe amvisëri me fëmijë të vegjël.**
- **Komisioni Rregullator Energjetik duhet të kryen analiza të rregullta në bashkëpunim me qendra hulumtuese, Ministrinë e Ekonomisë dhe aktorë tjerë, mbi marrëdhënien mes rritjes së energjisë elektrike dhe shtrirjen e konsumatorëve social të cenueshëm, gjatë rritjes së energjisë elektrike që të arrin çmimin e tregut.**
- **Ministria e Ekonomisë në bashkëpunim me aktorë të tjerë të zhvillon një studim të tregut të nxehtësisë në Maqedoni, me qëllim të përmirësimit të tregut të nxehtësisë si masë kundër varfërisë energjetike me theks të posaçëm mbi përmirësimin e shërbimeve për ngrohje qendrore, uljen e nivelit të energjisë kot të harxhuar duke zëvendësuar ngrohjen elektrike me praktika efikase të bio-masës, gazit natyror, përdorimit të rritur të lëndëve të ripërtrishme dhe përmirësim të efikasitetit energjetik.**
- **Përfundimisht të themelohet Fondi për Efikasitet Energjetik , që gjithashtu duhet të bëhet burim i financimit të efikasitetit**



energjetik dhe projekteve për energji të ripërtrishme për amvisëritë.

- Komunat duhet të përfshijnë çështjen e varfërisë energjetike në planet e tyre për efikasitet energjetik, duke përfshirë zbatimin e masave për efikasitet energjetik edhe në amvisëri, duke konsideruar zbatimin e projekteve lokale të gazifikimit, me qëllim që të sjellin gazin natyror në amvisëri dhe të ndërtojnë mjeteve të vogla për kogjeneracion.
- Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Energjetikës dhe aktorë të tjerë në bashkëpunim me komunat, organizatat qytetare etj., të nisin fushata vetëdijesimi mbi domethënien e varfërisë energjetike dhe rëndësinë e zbatimit të masave për

efikasitet energjetik si një prej mënyrave për zgjedhje të këtij problemi në nivel kombëtar dhe lokal.

- Amvisëritë që i takojnë shtresës së mesme të shoqërisë, veçanërisht me pensionistët dhe fëmijët e vegjël duhet të investojnë në efikasitet energjetik në shtëpitë e tyre dhe nëse është e mundur, të konsiderojnë përdorimin e koftorëve me dru që janë më efikas, si dhe llojeve të tjera të bio-masës, dhe jo vetëm drunjve.

## LITERATURA E PËRDORUR

Ana Stojilovska, "The story of the Macedonian heat market – how to reform it?" *Analytica*, (2012)

Boardman, Brenda, *Fuel Poverty: From Cold Homes to Affordable Warmth*, (London, 1991)

DHC+ *Technology Platform*, District Heating Cooling A vision towards 2020-2030-2050, (2009)

Energy Agency of the Republic of Macedonia, Annual report for 2012, (2013)

Energy Community Regulatory Board, Treatment of the vulnerable customers in the Energy Community, (2013)

Energy Community Secretariat, Annual report on the implementation of the acquis under the Treat establishing the Energy Community, (2012)

Energy Community, Memorandum of Understanding on Social Issues in the context of the Energy Community, (Vienna, 2007).

Energy Law, Official Gazette 16/11, Article 9

Energy Regulatory Commission of the Republic of Macedonia, Action plans to reduce energy poverty – Experience of Republic of Macedonia

First National Energy Efficiency Action Plan 2010-2018, (Skopje, 2010)

Government of the Republic of Macedonia, Ministry of Economy, Strategy for utilizing the renewable sources of energy in Republic of Macedonia till 2020, (Skopje, 2010)

Government of the Republic of Macedonia, Strategy for Improving Energy Efficiency in the Republic of Macedonia until 2020, (Skopje, 2010)

Group of members of the Parliament, Draft law on social protection against energy poverty, (Skopje, 2008)

Human Development Statistical Annex, page 151, Table 7. Internet page of UNDP

[http://hdr.undp.org/en/media/HDR\\_2011\\_EN\\_Tables.pdf](http://hdr.undp.org/en/media/HDR_2011_EN_Tables.pdf) last accessed on 22.09.2013

IEA, Co-generation and Renewables. Solutions for low-carbon energy future, (2011)

IEA, Energy in the Western Balkans The path to reform and reconstruction, (2008)





IEA, Technology Roadmaps Energy efficient buildings: Heating and cooling equipment, (2011)

Internet page of AMAN/ AMAN IT IS ENOUGH! One year from the most massive social protests in Macedonia

[http://amanmk.files.wordpress.com/2013/08/972361\\_315195735291058\\_167720378\\_n.png](http://amanmk.files.wordpress.com/2013/08/972361_315195735291058_167720378_n.png) last accessed 22.09.2013

Internet page of Analytica/ Analytica commenting on the draft law amending the Energy law submitted by the citizens' initiative AMAN [http://www.analyticamk.org/index.php?option=com\\_content&view=article&id=333:analytica-commenting-on-the-draft-law-amending-the-energy-law-submitted-by-the-citizens-initiative-aman&catid=52:energy-and-infrastructure&Itemid=167](http://www.analyticamk.org/index.php?option=com_content&view=article&id=333:analytica-commenting-on-the-draft-law-amending-the-energy-law-submitted-by-the-citizens-initiative-aman&catid=52:energy-and-infrastructure&Itemid=167) last accessed on 22.09.2013

Internet page of the Energy Community/ Treaty [http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC\\_HOME/ENERGY\\_COMMUNITY/Legal/Treaty](http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/ENERGY_COMMUNITY/Legal/Treaty) last accessed on 22.09.2013

Macedonian Academy and Science and Arts, Program for Realizing the Strategy for Energy Development in the Republic of Macedonia for the period 2012-2016, (Skopje, 2012)

Milica Andonov, Ministry of economy, Results from financing solar collectors, Presentation at conference Financing energy efficiency and renewable, Energy week Macedonia 2012

Ministry of Economy of the Republic of Macedonia, Strategy for Energy Development in the Republic of Macedonia until 2030, (Skopje, 2010)

Ministry of Transport and Communications, Housing Strategy of the Republic of Macedonia 2007-2012, (2007)

Municipality of Bitola, Program for energy efficiency of the municipality of Bitola 2009-2013, (2009)

Municipality of Caska, Program for energy efficiency 2011-2015

Municipality of Gevgelija, Program for energy efficiency of the municipality of Gevgelija 2009-2013, (2009)

Netpres, DNEVNIK: The Parliament did not support the Law on protection against energy poverty from 19.11.2008, Internet page of Netpress <http://www.netpress.com.mk/mk/vest.asp?id=44475&kategorija=7> last accessed on 23.09.2013

Official Gazette 94/13

Official Journal of the European Union L 211, Volume 52, (2009).

Panta Dzambazoski, Telma, The Parliament has rejected AMAN's initiative from 13.02 2013, Internet page of Telma <http://telma.com.mk/index.php?task=content&cat=1&rub=15&item=24135> last accessed on 22.09/2013

Pippa Gallop et all, Invest in haste, repent at leisure, (2013)

Program for amending the Program for Subsidizing Energy Consumption for 2012, Official Gazette 83/12

Program for Subsidizing Energy Consumption for 2011, Official Gazette 6/11

Program for Subsidizing Energy Consumption for 2012, Official Gazette 8/12

Program for Subsidizing Energy Consumption for 2013, Official Gazette 4/13

Program for Subsidizing Energy Consumption, Official Gazette 113/10

Questionnaires for municipalities of Karposh, Strumica and Kumanovo, answered January and February 2013

Ristovski and Sarachini: The increase of the subsidy for energy poverty can cover 50% of the bills from 09.06.2012, Internet page of the Government of the Republic of Macedonia <http://www.vlada.mk/node/3439> last accessed on 22.09.2013.

State Statistical Office, Household consumption in the Republic of Macedonia, 2009, (Skopje, 2010)

State Statistical Office, Household consumption in the Republic of Macedonia, 2010, (Skopje, 2011)

State Statistical Office, Household consumption in the Republic of Macedonia, 2011, (Skopje, 2012)

State Statistical Office, Household consumption in the Republic of Macedonia, 2012, (Skopje, 2013)



*State Statistical Office, Labour force survey, 2012, (Skopje, 2013)*

*State Statistical Office, News Release Energy Balances, 2011, No: 6.1.12.82, (2012)*

*State Statistical Office, News Release Relative poverty in 2011 No: 4.1.12.50, (2012)*

*Stefan Bouzarovski et al, The governance of energy poverty in Southeastern Europe, Ifri, (2011)*

*Stefan Bouzarovski, Energy poverty in transition: Macedonia and the Czech Republic in comparative perspective, Political Thought, Year 8, No. 29, (Skopje, 2010)*

*Stefan Buzar, Energy Poverty in Eastern Europe: Hidden Geographies of Deprivation, (2007)*

*Toplifikacija AD Skopje, Annual report 2008*

*Toplifikacija AD Skopje, Annual report 2009 year*

*Toplifikacija Inzenering dooel, Program for energy efficiency in the municipality of Kratovo for 2012-2014, (Skopje, 2011)*

*Toplifikacija Inzenering dooel, Program for energy efficiency in the municipality of Tetovo for 2012-2014, (Skopje, 2011)*

*UNDP, National Strategy for Clean Development Mechanism for the first commitment period of the Kyoto Protocol 2008 - 2012*

*USAID, Macedonia Energy Efficiency and Renewable Energy Assessment Final Report (2009)*

*World Bank, Report No. 48983-MK, FYR of Macedonia Energy Policy Note (Draft), (2009)*

*World Bank, Status of energy efficiency in the Western Balkans, (2010)*



## PËR AUTORËT

**Ana Stojilovska** (1985) është një hulumtuese e diplomuar nga Programi për Energji dhe Infrastrukturë në Analytica Think Tank, Shkup. Ajo ka Master diplomë për Studime Evropiane nga Europa-Kolleg Hamburg, Universiteti i Hamburgut. Stojilovska është autore e disa dokumenteve politike në fushën e energjisë. Fushat e saja të kërkimit janë: politikat energjetike, efikasiteti energjetik, energjia e ripërtrishme, tregu për ngrohje, gazifikimi, siguria energjetike, kogjenerimi, varfëria energjetike, rrjetet tans-evropiane, zhvillimi i qëndrueshëm, ndryshimet klimatike, EU acquis – kapitujt 15, 21, bashkëpunimi mes Qeverisë dhe shoqërisë civile – të gjitha të lidhura me Maqedoninë. Ajo mund të kontaktohet në e-mailin: [astojilovska@analyticamk.org](mailto:astojilovska@analyticamk.org)

**Sonja Zuber** (1984) është Koordinatore e Hulumtimeve dhe Menaxhimit në Analytica Think Tank Shkup. Ajo gjithashtu është përgjegjëse edhe për Programin Përfaqësues për Aderim në BE dhe Integrim në Analytica. Ajo ka Master diplomë për Studime Evropiane nga Hochschule Bremen, Gjermani, diplomë për Shkenca Politike nga Fakulteti Juridik në Shkup. Analizat dhe dokumentet tjera në fushën energjetike që ka punuar: Analizë e Ligjit për Ndryshimin dhe Amendamente të Ligji për Energji miratuar në maj 2013, Komuniteti Energjetik i Evropës Juglindore: Kërkimi i qasjeve të reja për përmirësimin e bashkëpunimit rajonal (një alternativë për Zgjerim të BE-së?), Ndryshimi i shprehive – si të kaloni në një komunë me efikasitet energjetik – Manual, etj. Kontakti: [sristeska@analyticamk.org](mailto:sristeska@analyticamk.org)

**Mendimet e shprehura në këtë analizë janë këndvështrimet personale të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e Fondacionit Konrad Adenauer.**

## Kontakt:

### **Fondacioni Konrad-Adenauer**

Maksim Gorki 16 / kati 3  
MK – 1000 Shkup  
Telefon +389 (2) 3231 122  
Telefaks +389 (2) 3135 290  
[Skopje@kas.de](mailto:Skopje@kas.de)  
[www.kas.de/macedonia](http://www.kas.de/macedonia)

### **Analytica**

Dame Gruev 7-8/3  
MK-1000 Shkup  
Telefon +389 (2) 312 1948  
Telefaks +389 (2) 312 1948  
[info@analyticamk.org](mailto:info@analyticamk.org)  
<http://analyticamk.org/>